



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 186/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Agromarket KS Doo, me nr. unik identifikues 811183293, me seli në Magj. Prishtinë – Shkup, km 6, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Sh.M.R. nga Kamenica, kundër debitorit B.T. B.I, me nr. të biznesit 81133421, me seli në Prizren, me përfaqësues të autorizuar A.T.” nr.30 duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1059/23 të datës 29.11.2023, me datë 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e Kreditorit Agromarket KS Doo, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1059/23 të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar 1059/23 të datës 29.11.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit B.T. B.I., me numër unik identifikues 81133421, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr. 192/2021, i lejuar me datë 24.05.2019, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,032.84 EUR, dhe procedura në këtë pjesë të përmbartimit, Përfundohet. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit B.T. B.I nga Prizreni dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 192/2021 i lejuar 24.05.2019, nga përmbartuesi privat Kushtrim Musa për

borxhin në lartësi prej 733,67 EUR së bashku me kamatën ligjore në këtë pjesë të borxhit si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, shkeljeve të dispozitave ligjore të LPP, konstatimit të gabuara apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuara të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1059/23 të datës 29.11.2023

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë më të cilën ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë, që të refuzoj në tërësi ankesën e kreditorit dhe të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1059/23 të datës 29.11.2023

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Agromarket KS Doo me dt. 24.05.2019, ka paraqitur propozim për përbarim mbi bazën e dokumenteve të besueshme - faturë nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019, faturë nr. 14-1002-10-005- e datës 02.10.2019 dhe faturë nr. 14-1002-19-006 e datës 02.10.2019 duke detyruar debitorin që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura, t'ia paguaj kreditor shumë prej 5,766.51 EUR, me kamatë ligjore prej 8% arritja për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore

Përbaruesi Privat Kushtrim Musa me seli në Gjiilan, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr. 192/2021 të 24.05.2019, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit duke theksuar se kreditori dhe debitori, me datë 01.10.2019 kanë lidhur kontratë për furnizim me produkte, ku në nenin 4 të saj, është paraparë që afati i pagesës së faturave të jetë 30 ditë, përveç fatura e parë me konsignim në vlerë prej 6,000.00

euro e datës 01.10.2019. Ka shtuar se në këtë rast, faturat objekt i këtij përmbartimi janë me konsignim, që nënkupton se malli i marrë nga debitori ka mbetur ende pronë e shitësit, ashtu që në rast të ndërprerjes së bashkëpunimit malli tërheqë dhe vlera e kthimit zbritet nga vlera e tij, ndërsa blerësi detyrohet të paguaj vetëm diferencën e mbetur pas kthimit të mallit. Kreditori, ka parashtruar përgjigje në prapësim duke shtuar se nuk qëndron pretendimi se kreditori me debitorin kanë pasur marrëveshje për konsignim, por debitori e ka shtuar këtë vetëm sa për ta prolonguar çështjen. Ka shtuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet ligjore për lejimin e përmbartimit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren PPP.nr. 184/2021 të datës 01.03.2022, Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 496/23 të datës 10.05.2023, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse në seancën dëgjimore 21.11.2023, dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje si LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaket si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbartimor P.nr. 192/2021, i lejuar me datë 24.05.2019, gjeti se fatura nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019, si një nga tri (3) faturat mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi, nuk është e përshtatshme për përmbartim dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbartimit pasi që përkundër faktit se fatura e lartcekur është pranuar me rregull nga debitori, e njëjta nuk e vë në detyrim debitorin për pagesën e saj. Kete vlersim gjykata e beri pasi që palët ndërgjyqëse, me kontratën për furnizim të datës 01.10.2019, në nenin 4 të saj, janë pajtuar që fatura e parë që buron nga ky raport kontraktual, dhe atë në vlerë prej

6,000.00 EUR është faturë me konsignim, ndërsa faturat tjera duhet paguar në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të tyre. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se fatura nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019 është lëshuar menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, dhe mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese se e njëjta paraqet faturën e parë e cila buron nga kontrata e lartcekur. Andaj, me vet faktin se palët ndërgjyqëse janë pajtuar që fatura e lartcekur të jetë me konsignim, nënkupton se njëjta nuk e vë në detyrim monetar debitorin me rastin e pranimit të saj, pasi që malli në emër të të cilit është lëshuar kjo faturë nuk është blerë nga debitori. Rrjedhimisht, debitori ka mundur të vihet në detyrim sipas kësaj fature vetëm në rast të shitjes së mallit, në të kundërtën, obligimi i vetëm i debitorit në rast të mos shitjes është kthimi i mallit tek kreditori por jo edhe pagimi i çmimit të vlerës së mallit të marrë me konsignim.

Tutje Gjykata, duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: “1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë;” në lidhje me par. 1.6 të po të njëjtit nen i cili parasheh se “kreditore nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbarimin kundër debitorit” vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke shfuqizuar Urdhri Përmbarimor P.nr. 192/21 të datës 24.05.2021 në shumën prej 5,032.84 EUR, që buron nga fatura nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019.

Andaj Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr. 192/21 të datës 24.05.2021 në vlerë prej 733.67 EUR, pasi që në këtë pjesë të përmbarimit, urdhri mbështetet në faturën nr. 14-1002-10-005- të datës 02.10.2019 dhe faturën nr. 14-1002-19-006 të datës 02.10.2019 të cilat i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditore dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Andaj shkalla e parë konstatoi se faturat në fjalë janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga vënia e nënshkrimit dhe vulës nga debitori tek pranuesi i faturës, dhe të njëjtat janë dorëzuar në origjinal në përputhje me nenin 37 të LPP-së, andaj janë të përshtatshme për përmbarim dhe

paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit. Po ashtu me rastin e vendosjes, Gjykata e shkallës së parë vlerësoi pretendimin e kreditorit se kontrata mes palëve ndërgjyqëse ka pasur afat deri më 31.12.2019, ashtu që deri në këtë datë barazimi me debitorin është dashur të jetë në zero, por që debitori as nuk e ka kthyer mallin e as nuk e ka paguar çmimin, por që këto pretendime janë të natyrës materiale-juridike të cilat nuk janë objekt shqyrtimi në këtë procedurë përmbarimore, andaj kreditori, lidhur me pretendimet për mos kthim të mallit brenda afatit ligjor nga debitori, nuk ka pengesë që të inicioj kontest të rregullt juridik civil.

Po ashtu, Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se sipas nenit 4 të kontratës, afati për pagesën e faturave është tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit të tyre, gjë të cilën debitori nuk e ka bërë, por që nga me shiqimin e faturës nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019, Gjykata gjeti se e njëjta si datë të skadimit përmban vet datën e lëshimit të faturës, andaj e njëjta nuk i referohet faturave tjera të cilat sipas nenit 4 të kontratës për furnizim duhet paguar pas kalimit të afatit 30 ditor, por i referohet faturës së parë të dakorduar mes palëve, e cila rezulton se ka qenë me konsignim.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përmbarimor për pjesën e borxhit prej 5,032.84€, ngase, me kontratën e lidhur ndërmjet paleve për furnizim të datës 01.10.2019, në nenin 4 të saj, janë pajtuar që fatura e parë që buron nga ky raport kontraktual, dhe atë në vlerë prej 6,000.00 EUR është faturë me konsignim, ndërsa faturat tjera duhet paguar në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të tyre. Në këtë drejtim, kjo Gjykatë gjeti se fatura nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019 është lëshuar menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, dhe mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese se e njëjta paraqet faturën e parë e cila buron nga kontrata e lartcekur. Andaj, me vet faktin se palët ndërgjyqëse janë pajtuar që fatura e lartcekur të jetë me konsignim, nënkupton se njëjta nuk e vë në detyrim monetar debitorin me rastin e pranimit të saj, pasi që malli në emër të të cilit është lëshuar kjo faturë nuk është blerë nga debitori. Rrjedhimisht, debitori ka mundur të vihet në detyrim sipas kësaj fature vetëm në rast të shitjes së mallit, në të kundërtën, obligimi i vetëm i debitorit në rast të mos shitjes është kthimi i mallit tek kreditori por jo edhe pagimi i çmimit të vlerës së mallit të marrë me konsignim.

Po ashtu Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbimore kur në pikën II të dispozitivit Urdhri Përmbimor P.nr. 192/21 të datës 24.05.2021 në vlerë prej 733.67 EUR, pasi që në këtë pjesë të përmbimit, urdhri mbështetet në faturën nr. 14-1002-10-005- të datës 02.10.2019 dhe faturën nr. 14-1002-19-006 të datës 02.10.2019 të cilat i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Po ashtu se faturat në fjalë janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga vënia e nënshkrimit dhe vulës nga debitori tek pranuesi i faturës, dhe të njëjtat janë dorëzuar në origjinal në përputhje me nenin 37 të LPP-së, andaj janë të përshtatshme për përmbimorim dhe paraqesin bazë për lejimin e përmbimorit.

Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se kontrata mes palëve ndërgjyqëse ka pasur afat deri më 31.12.2019, ashtu që deri në këtë datë barazimi me debitorin është dashur të jetë në zero, por që debitori as nuk e ka kthyer mallin e as nuk e ka paguar çmimin, por që këto pretendime janë të natyrës materiale-juridike të cilat nuk janë objekt shqyrtimi në këtë procedurë përmbimorimor, andaj kreditori, lidhur me pretendimet për mos kthim të mallit brenda afatit ligjor nga debitori, nuk ka pengesë që të inicioj kontest të rregullt juridik civil. Po ashtu vlerësoi pretendimin e kreditorit se sipas nenit 4 të kontratës, afati për pagesën e faturave është tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit të tyre, gjë të cilën debitori nuk e ka bërë, por që nga me shikimin e faturës nr. 14-1002/19-004 e datës 02.10.2019, Gjykata gjeti se e njëjta si datë të skadimit përmban vet datën e lëshimit të faturës, andaj e njëjta nuk i referohet faturave tjera të cilat sipas nenit 4 të kontratës për furnizim duhet paguar pas kalimit të afatit 30 ditor, por i referohet faturës së parë të dakorduar mes palëve, e cila rezulton se ka qenë me konsignim.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.186/24 me datë 16.04.2024**

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**